



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2020:003058

Datë: 08.10.2021

Numri i dokumentit: 02260467

P.nr.2/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësen Suzana Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit D.B nga fshati ... Komuna e Hani Elezit, i akuzuar për shkak të veprës penale Vjedhja pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.2284-2/19 të datës 09.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 23.09.2021, publik, në praninë e Prokurores së Shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 08.10.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: D.B nga fshati ... Komuna e Hani Elezit, i lindur më datë 05.06.1989, nga i ati ... dhe e ëma ... e gjinisë ..., me numër personal ..., beqar, ka të kryer shkollën fillore, punon në ndërtimtari, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës, i gjykuar edhe më parë.

## ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 02.12.2019, rreth orës 15:05, në vednin e ashtuquajtur “...”, në territorin e fshatit ..., Rajoni Ekonomiko-PyJOR ..., pyll publik, me qëllim të vjedhjes ka prerë më sharrë motorike 39 (tridhjetë e nëntë) drunjë të lojit Ahu, me diametër 10-30 cm, me gjatësi 8m, me vëllim të përgjithshëm prej 2.43 m<sup>3</sup>, në vlerë të përgjithshme prej 358.02€, të cilat trungje pastaj i ka ngarkuar në traktorë për të i transportuar në shtëpi, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarës Autoritetit PyJOR Komunal-Hani Elezit dëme në vlerë prej 358,02€.

Me të cilat veprime ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 2, 17, 38, 39, 43, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, 359, 360, 361 dhe 365 të KPPK-së, i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

I. Dënim me gjobë në shumë prej 500€ (Pesë qind euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri në afat prej 1 viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do t'i revekohet.

II. Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar të i' a paguaj dëmin në vlerë prej 358.02€, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, si dhe Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 30€ të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.2284-2/19 të datës 09.01.2020, kundër të pandehurit të lartë shënuar për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit

nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqipton sanksion penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 23.09.2021.

Pas leximit të aktakuzës, i pandehuri e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, dhe ka theksuar se drunjtë i ka marrë për nevoja personale, është penduar dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale dhe ka kërkuar nga gjykata që t'i shqiptoj një dënim sa më të ulët.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza ligjore nga neni 248 të KPRK-së për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 4 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; pranimi është bërë vullnetarisht; - pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, si në mënyrë, datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, konform neneve 69, 70, të KPRK-së gjykata vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale dhe tash ka siguruar punë në ndërtimtari për sigurimin e të ardhurave personale, ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti.

Sipas bindjes së Gjykatës dënimi i kushtëzuar i shqiptuar ndaj të pandehurit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë, minimumin dhe maksimumin e dënimit dhe gjendjes ekonomike të pandehurit është dënim i drejtë dhe me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimi për kompensimin e palës së dëmtuar është marrë në bazë të nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së dhe në pranimin e fajësisë për të gjitha pikat e aktakuzës

Konform neni 451 paragrafi 1 të KPP-ës, të pandehurin e obligohet që t'i paguaj shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi

Konform neni 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligon të pandehurin që të paguaj shumën prej 30.00 € Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.nr.2/20 datë 08.10.2021

Procesmbajtësja  
Suzana Rudi

Gjyqtari  
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.